

Ofertat tona në pika të shkurta

Qendrat tona për përkujdesje ju ofrojnë shtëpi përsonave të moshuar, të cilët kanë nevojë për përkujdesje. Banueset dhe banuesit tanë duhet ta ndiejnë vehtën tek ne mirë dhe rehat. Kualiteti optimal i jetës se tyre është për ne qellim kryesor.

Trajtimi mjeksor, përkujdesja dhe mbështetja bëhen sipas njohurive më moderne. Ato synojnë ti shoqrojnë banueset dhe banuesit sipas nevojave të tyre dhe të përkrahin pavarësinë e tyre. Mbështetje të mëtejshme ofrojnë terapia fizike, ergoterapia dhe terapia aktivizuese. Kësaj i shtohet edhe ushqimi i ekuilibruar me zgjedhje të menysë dhe aktivitetet e ndryshme në shtëpi. Me qëllim të përmbushjes optimale të detyres sonë, përkujdesemi për kontaktin me familjarët e banueseve dhe banuesve tanë.

Ofertat dhe Orientimet

Përkujdesja dhe banimi

Repartet për Përkujdesje dhe Banim janë reparte tona standarde pa orientime të specializuara.

Ofertat për përsona të sëmurë nga demenci

Përsonat e sëmurë nga demenci, të cilët janë të rrezikuar nga ikja, jetojnë tek ne në repartet me masa të shtuara mbrojtëse. Këto parandalojnë, që banueset dhe banuesit e hutuar të ikin dhe të mos dinë të kthehen më. Lirija e lëvizjes përbrenda reparteve është e garantuar, poashtu i garantuar është edhe kontakti me boten e jashtme përmes shetive të regullta dhe pikniqeve. Përkujdesja dhe mbështetja bazohen në njohuritë më të reja në lëminë e sëmundjeve të demencit.

Ofertat për të hendikeparit në mobilitet dhe personave të rrezikuar nga rrëzimi

Trajnimi i synuar dhe intensiv i rehabilitimit favorizon lirinë e lëvizjes dhe me këtë pavarësinë e banueseve dhe banuesve. Kjo ofertë i përshtatet personave, të cilët janë të aftë për trajnim dhe kanë dëshirë të marrin pjesë rregullisht në orët e trajnimit.

Ofertat për përsonat mentalisht aktiv

Këtu takohen personat, të cilët mund të vejnë kontakte dhe të kujdesen për to, të cilët parapëlqejnë diskutimet sie dhe aktivitetet e përbashkëta me banueset dhe banuesit tjerë.

Përkujdesja Lehtësuese (palliative)

Medicina dhe përkujdesja palliative (lehtësuese) është specializuar për nevojat e përsonave të sëmurë rëndë ose të atyre që janë para vdekjes. Qëllimi i palliacionit (lehtësimit) është ruajtja e kualitetit të mundshëm jetsorë përmes lehtësimit të dhimbjeve trupore dhe atyre shpirtore. Në qendrat e kujdesit bëhet përkujdesja, mbështetja dhe shoqrimi në vdekje, e personave me sëmundje të pasheruara, sipas parimeve të kujdesit palliativ.

Ofertat dhe orientimet tjera

- për personat me prejardhje nga vendet mediterane
- për personat me sëmundje psiqike kronike
- për personat me deficite neurologjike
- për rehabilitim psyhosozial
- për pacientet MRSA
- për personat me mbi peshë
- për personat me nevojë për përkujdesje të veçantë (banueset/banuesit me frymarrje artificiale, banueset/banuesit me Traheostomi, banueset/banuesit me kurim të veçantë të plagëve)

Ofertat dhe orientimet e ndryshme rafinohen dhe u përshtaten vazhdimisht nevojave të banueseve dhe banuesve tanë.

Repartet e Sigurimit Invalidor

Kjo ofertë i dedikohet personave të rritur por në moshë më të re, të cilëve u takon Pensioni-IV 100% dhe të cilët kanë nevojë për përkujdesje dhe mbikëqyrje. Në repartet tona gjejnë ata hapsirë për banim dhe jetesë, e cila i përshtatet moshës dhe nevojave të tyre. Aktivitetet, kushtet dhe hapsirat e lira janë të projektuara në atë mënyrë, që të ofrojnë mundsi të mëdha të vetvendosjes dhe të tërheqjes.

Përkujdesja Kalimtare

Kjo ofertë i dedikohet personave, të cilët pas qëndrimit në spital nuk janë të gatshëm për kthim në shtëpi. Përkujdesja kalimtare u ofron atyre një ambient aktiv dhe rehabilitues, ku mund ti rikthejnë forcat e tyre dhe të ushtrojnë një jetesë të pavarur.

Përkujdesja kalimtare i dedikohet pacienteve dhe pacientve, të cilëve nuk u nevojitet trajtim medicinal-teknik dhe/ose terapeutik të një spitali akut, sie dhe kanë potencial trupor dhe shpirtor për rikthim në shtëpi.

Grupet e Banimit

Grupet të Banimit nën Përkujdesje

Grupet nën Përkujdesje janë njësi të vogla banimi, të cilat banueseve dhe banuesve mobil u ofrojnë mundësi të banimit individual, por gjithnjë me mundësi të takohen si grup. Këto grupe të banimit gjenden zakonisht në kuadër të Kompleksit të Qendrave për Përkujdesje.

Grupet Eksterne të Banimit nën Përkujdesje

Qendrat për përkujdesje udhëheqin dhjetë grupe të banimit nën përkujdesje me orientime të ndryshme. Këtu kemit të bëjmë me bashkësi të banimit nën përkujdesje, të cilat janë të lidhura me një Qendër për Përkujdesje, por që jetojnë kryesisht autonom. Banueset dhe banuesit marrin pjesë sipas dëshirës dhe mundësive në detyrat e përditshmërisë, siq janë përgatitja e ushqimit, furnizim me gjëra ushqimore etj. Në shumicën e këtyre grupeve të banimit nën përkujdesje jetojnë persona të sëmur nga demenci por që janë ende mobil, grupet tjera ofrojnë orientime tjera.

Përkujdesja Mjeksore, Këshillimi Përshpirtor

Përgjegjës për përkujdesje medicinale në ofertat tona janë mjeket dhe mjekt tanë. Pos kësaj mund të kontaktohen sipas dëshirës edhe kujdestarët përshpirtor të shtëpive tona.

Me rëndësi:

Kusht për pranim në njërin nga qendrat tona është vendbanimi në qytetin e Cyrihut.

Ofertat Ambulatore

Memory-Klinika në Entlisberg është një këshillimore dhe vend sqarimi për persona me çrregullime të kujteses dhe demenc.

Vizitat Shtëpiake SiL/ZMI (zgjidhjet medicinalsociale individuale) është një ofertë e lidhur ngusht me Memory-Klinikën në Entlisberg. Ajo përmbanë në vete vizita shtëpijake tek personat e sëmurë nga demenci ose çrregullimeve tjera të kujteses, për të sqaruar situatën aktuale dhe për ti mbështetur ata në përditshmëri.

Organizimi i ofertave plotësuese të mbështetjes dhe përkujdesjes në shtëpi: Për personat, për të cilët duhet përkujdesur në shtëpi dhe për familjarët e tyre ofrojnë Qendrat për Përkujdesje të Qytetit të Cyrihut oferta fleksibile dhe individualisht të përshtatura, të cilat u mundësojnë të interesuarve, të mbesin sa më gjat në shtëpi.

Informatat:

Për pranim në një nga qendrat tona për përkujdesje ose në ofertat plotësuese për mbikëqyrje dhe përkujdesje në shtëpi:

Beratungsstelle "Wohnen im Alter" (Këshillimorja „Banimi në Pleqëri“)

Tel. 044 388 21 21 ose wohnenimalter@zuerich.ch

Për ofertat e Memory-Klinikes në Entlisberg dhe për Vizitat Shtëpiake ZMI:

Gerontologische Beratungsstelle (Këshillimorja Gerontologjike)

Tel. 043 495 18 18 ose gerontologische.beratungsstelle@zuerich.ch